

KU DUHET TË DREJTOHESH PËR TË MARRË NDIHMË LIGJORE PARËSORE:

- ✓ Në Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore. Në këto Qendra që ndodhen pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe bashkive, shërbimi ofrohet nga punonjës me trajnim të posaçëm.
- ✓ Në organizatat jofitimprurëse, të autorizuar për të ofruar këtë lloj shërbimi.
- ✓ Në klinikat ligjore, pranë universiteteve.

CILA ËSHTË PROCEDURA ...

- ✓ Duhet të paraqisni kërkesën për ndihmë ligjore parësore me gojë ose me shkrim pranë Qendrës së Shërbimit ose një Organizate Jofitimprurëse të autorizuar.
- ✓ Kërkesa paraqitet nga personi që kërkon të përfitojë ndihmë juridike parësore. Fillimisht duhet të nënshkruani një vetëdeklarim sipas formatit të miratuar paraprakisht nga Ministri i Drejtësisë. Këtij vetëdeklarimi duhet t'i bashkëngjisni dokumentat justifikues, me anë të cilave vërtetoni se i keni përmbushur kriteret e përcaktuara.
- ✓ Ndihma juridike ju ofrohet menjëherë sapo depozitoni kërkesën. Kur ofrimi i menjëhershëm i ndihmës është i pamundur, ju informoheni për datën dhe kohën kur do t'ju ofrohet.
- ✓ **KUJDES!** Ju keni të drejtë të përfitoni ndihmë juridike falas për një çështje ose problematikë vetëm 1 herë, me përjashtim kur shfaqen rrethana të reja.
- ✓ Nëse gjatë ofrimit të shërbimit rezulton se ju nevojitet përfaqësim dhe mbrojtje përpara Gjykatës, do të informoheni dhe do t'ju ofrohet ndihma e duhur për plotësimin e kërkesës për të përfituar nga ndihma juridike dytësore.
- ✓ Të dhënat e tua personale ruhen në bazë të ligjit në një procesverbal, i cili përpilohet nga ana e punonjësit që ju ka ofruar ndihmën juridike parësore.

Për çdo informacion rreth të drejtës suaj për ndihmë ligjore **FALAS** mos hezitoni të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit.

KSHH pas studimit të çështjes tuaj dhe hapësirave ligjore do ju këshillojë për t'ju drejtuar institucioneve kompetente/gjykatës, edhe në rast se ju nuk i plotësoni kriteret ligjore.

Nëse rasti juaj paraqet nevojë për një shërbim ligjor më të specializuar, KSHH do ju adresojë pranë Qendrave të Klinikave të Ligjit të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë në Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Zyrës së Ndihmës Ligjore Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ju siguron ruajtje të konfidencialitetit dhe pas ofrimit të shërbimit ligjor **FALAS** të dhënat e tua personale do të asgjësohen në përputhje me ligjin në fuqi.



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Na kontaktoni:

+355 04 223 3671

+355 69 40 757 32

+355 69 20 236 99

e-mail: office@ahc.org.al

Kodi postar: 1752

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rruga Brigada VIII, Pallati "Tekno Projekt",
Shkalla 2, Apartamenti 10, Kati 6
Tiranë, Shqipëri

www.ahc.org.al

Kjo fletëpalosje u përgatit nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) në kuadër të zbatimit të nismës "Të ndihmojmë për njohjen dhe zbatimin efektiv të legjislacionit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti në Shqipëri", me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

KENI NJË PROBLEM LIGJOR?



Kjo fletëpalosje ju ofron informacionin e nevojshëm, nga duhet t'ja filloni për të marrë ndihmë ligjore falas në lidhje me problemin tuaj.

A E DINI SE?

Ju mund të përfitoni ndihmë ligjore falas të garantuar nga shteti, në bazë të Ligjit nr. 111/2017.

Ndihma ligjore parësore përfshin:

- ✔ ofrimin e informacionit për legjislacionin në fuqi;
- ✔ këshillimin ligjor për zgjidhjen konkrete të rastit tuaj;
- ✔ këshillimin mbi ndërmarrjen e procedurave të ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative;
- ✔ ofrimin e ndihmës në hartimin e dokumentacionit për të vënë në lëvizje administratën shtetërore dhe përfaqësim para organeve administrative.

PËR TË PËRFITUAR NDIHMË LIGJORE FALAS:

HAPI I

Ju duhet të provoni se keni të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.



Mund të përfitosh ndihmë ligjore falas, nëse:

1. **Je shtetas shqiptar** me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë;
2. **Je shtetas i huaj ose person pa shtetësi**, por qëndron në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe jeni i pajisur me leje qëndrimi;
3. **Je shtetas i huaj**, ose person pa shtetësi, keni hyrë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përfiton mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose bazuar në parimin e reciprocitetit;
4. **Je azilkërkues**, person që gëzon statusin e refugjatit dhe person ndodhesh në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit.

Cilat konsiderohen të ardhura/pasuri e pamjaftueshme ?

- ✔ Nëse ju jetoni në një familje, të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50% e pagës minimale mujore të përcaktuar, pra janë më të ulëta se 13,000 lekë.¹
- ✔ Nëse nuk jetoni në një familje, të ardhurat janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar, e cila është 26,000 lekë
- ✔ Vlera në total e pasurisë nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore, pra nuk tejkalon shumën prej 936,000 lekë.

¹ VKM nr.809, datë 26.12.2018, paga minimale për vitin 2019 ka ndryshuar nga 24.000 lekë në 26.000 lekë

Pavarësisht të ardhurave/pasurisë, përfiton ndihmë juridike falas nëse:

- ✔ Je viktimë e dhunës në familje;
- ✔ Je viktimë e abuzuar seksualisht dhe viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- ✔ Je viktimë e mitur dhe i mitur në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ✔ Je i mitur dhe jeton në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- ✔ Je i mitur nën kujdestari dhe kërkon të nisësh një proces pa miratimin e kujdestarit ligjor ose kundër kujdestarit tënd ligjor;
- ✔ Je përfitues i pagesës për aftësinë e kufizuar;
- ✔ Gëzon statusin e të verbrit;
- ✔ Po i nënshtrohesh procedurave të trajtimit të pavullneshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor;
- ✔ Po i nënshtrohesh trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, për sëmundjet e rënda mendore;
- ✔ Ndaj jush është kërkuar heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar;
- ✔ Të është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar dhe kërkon të nisësh një proces kundër kujdestarit ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar;
- ✔ Je përfitues i skemave të mbrojtjes sociale;
- ✔ Je diskriminuar dhe disponon një vendim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

